



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01 Nr 070/01-23966 dt. 03.07 2020

Në bazë të nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 4, 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 98 të Statutit të Komunës së Glllogocit, Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e jashtëzakonshme, të mbajtur me datë 08.07.2020, të miratoj këtë:

DRAFT DEKLARATË

1. Konfirmojmë qëndrimin tonë dhe bindjen e paluhatshme se lufta mbrojtëse e qytetarëve të Kosovës, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, përkrahur nga forcat e NATO-së, prirur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe bota demokratike, ishte luftë e drejtë dhe e pastër për çlirimin e Kosovës, kundër regjimit gjenocidal të forcave ushtarake dhe policore të Serbisë.
2. Vlerësojmë të paprecedent publikimin e njoftimit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar për një aktakuzë të pakonfirmuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake ndaj dy prej liderëve kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli. Solidarizohemi dhe shprehim njëzëri, mbështetjen e plotë dhe besimin e palëkundur në pafajësinë e tyre.
3. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta çmojë lart bashkëpunimin e institucioneve kosovare dhe ish-pjesëtarëve të UÇK-së me institucionet e drejtësisë ndërkombëtare përgjatë këtyre njëzet vjetëve, duke përfshirë Dhomat e Specializuara.
4. Si përfaqësues të qytetarëve të komunës së Drenasit, të njëjës nga komunat më të goditura nga gjenocidi serb, ku janë kryer dhjetëra masakra të tmerrshme nga forcat ushtarake e policore serbe, ndjehemi të fyer dhe të prekur thellë, sepse ende asnjë akuzë

R.W

nuk është ngritur ndaj planifikuesve, urdhërdhënësve apo kryesve të krimeve të gjenocidit serb, pra, ASNJË i dënuar nga drejtësia ndërkombëtare.

5. Kujtojmë masakrën e Vërbocit, Shtuticës, Poklekut, Abrisë, Likoshanit e dhjetëra masakra tjera, ku u vranë, dogjën, dhunuan dhe u zhdukën gra, burra, pleq, duke mos kursyer as foshnja e fëmijë. Nga të gjitha këto masakra të dëshmuara e të argumentuara, nuk ka ende asnjë akuzë ndërkombëtare apo të dënuar nga organet e drejtësisë.
6. Forcat ushtarake serbe dhe artileria e rëndë e tyre, shkaktoi miliarda euro dëme të luftës, duke shkatërruar dhe djegur mbi 70% të vendbanimeve, duke përfshirë shtëpi, ndërtesa, lokale, biznese, shkolla, objekte kulturore, fetare etj.
7. Përveç masakrave dhe krimeve në njerëz, agresori serb gjatë luftës plaçkiti edhe trashëgiminë materiale dhe kulturore duke marrë me vete shënimet kadastrale si: Shënimet e kadastrit përshkrues (dokumentacionin e viteve 1950-1960); Planet origjinale të viteve 1961-1967 -Regjistrat e fletëparaqitjeve - Regjistrat ABC të pronarëve; Regjistrin e parcelave; regjistrin e kulturave dhe klasave; Regjistrat e ndërrimeve kadastrale; Regjistrat e fletëposeduesve për secilin pronar dhe zonë kadastrale; Dokumentacionin e Komasionit; Aktvendimet mbi eksproprijimet të objekteve shoqërore; Dokumentacioni dhe elaborate i reformës agrare, kolonizimi, arondacionet, eksproprijimet, riorganizimit të kooperativave bujqësore, konfiskimet, shqyrtimin e uzurpimeve, fondet e tokave; Evidencë e përgjithshme e pasurisë së patundshme mbi të cilën ekziston e drejta e pronësisë së qytetarëve edhe personave civil - juridik. Këto dokumente edhe përkundër marrëveshjes së nënshkruar, akoma nuk janë kthyer.
8. Si përfaqësues të qytetarëve, të zgjedhur në mënyrë demokratike, bëjmë thirrje për unitet mes qytetarëve dhe bashkërendim të angazhimeve ndërmjet institucioneve të të gjitha niveleve dhe partive politike, për të mbrojtur vlerat e luftës dhe pastërtinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

 Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci